



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Kumtesë për media

Drejtësia kosovare promovon vrasjet: Vetëm 12 vite burgim për vrasësin e Zejnepe Berishës

Prishtinë, 12 Prill 2017

Sot Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) u njohtua përmes mediave lokale se vrasësi i viktimës së dhunës në familje, të ndjerës Zejnepe Berisha, me urdhër të Gjykatës Themelore të Prizrenit, është dënuar me vetëm 12 vjet burgim. Vrajsa ka ndodhur më 23 tetor të vitit 2015, ku vrasësi me thikë kishte shkaktuar vdekjen e saj. Gjatë tërë kësaj tragjedie, ishte lënduar edhe vajza e tyre.

Zejnepe Berisha për vite me rradhë iu ishte drejtuar institucioneve të Kosovës për të kërkuar mbrojtje, derisa një ditë ajo u sulmua me thikë dhe u vra. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në nenin 179 mbi Vrasjen e Rëndë thotë se “Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili: ... 1.3. privon nga jeta anëtarin e familjes”. Duke marrë parasysh rrethanat se si ka ndodhur kjo vrasje, peshën e veprës dhe dhunën sistematike që viktima ka përjetuar, konsiderojmë se dënimi nuk është proporcional me veprën e shkaktuar.

RrGGK, kërkon që vendimi mbi dënimin të apelohej dhe të ndryshohet. Përmes punës së saj, RrGGK shpesh ka bërë vizita edhe në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan, ku janë të burgosura gratë kosovare të cilat kanë kryer vepra penale. Në këtë qendër ne kemi rastisur gra të cilat janë dënuar me mbi 30 vjet burgim, në rastet kur ato janë vetëmbrojtur. E tërë kjo diskrepancë në dënime, në mes të vrasësve burra dhe atyre gra, na lë të kuptojmë që mirëqenia e grave dhe vajzave në Kosovë vazhdon të jetë e rrezikuar, e kjo sidomos nga institucionet të cilat në fakt do të duhej të na ofrojnë siguri, drejtësi dhe barazi në të gjitha sferat e jetës.